



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 13.06.2025

Numër Protokolli: 4195/2025

A.nr.650/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari -kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani anëtarë, me Driton Jashari në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.650/2025, të datës 15.04.2025 të parashtruar nga ankuesja I.R-Z ,kundër organit të punësimit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 13.06.2025 mori:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.650/2025 e datës 15.04.2025 e parashtruar nga ankuesja I.R-Z.

A r s y e t i m

Ankuesja I.R-Z (referuar më tutje si ankuesja) me datë 15.04.2025 ka parashtruar ankesë, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës regjistruar nën shenjën A.nr.650/2025 e protokolluar me nr.2480/2025, me pretendimin ankimor lidhur me parregullsitë kundër procedurave të konkursit me nr.reference RN00016856 të datës 25.02.2025, Grupi i administrimit të përgjithshëm, pozita Zyrtar Administrativ, klasa e pozitës Profesional 3.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 28.04.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa me datë 29.04.2025, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen administrative në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesa me shenjën A.nr.650/2025 me nr. prot 2480/2025 e datës 15.04/2025; Kopja e letërnjoftimit; Njoftimin e datë 10.04.2025 nga Divizioni i Burimeve Njerëzore të MFPT që njofton ankuesen që nuk plotëson kriteret e për përfshirje në listën e ngushtë.; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 28.04.2025; Përgjigje në ankesë e datës 29.04.2025; Konkursin e datës 25.02.2025 me afat aplikimi nga 26.02.2025 deri me date 27.03.2025; Lista e kandidatëve të aprovuar lidhur me konkursin RN00016856, si dhe lista e kandidatëve të refuzuar; Vendimin për themelimin e komisionit të vlerësimit për pranim me nr. Protokoli 1105/2025 të datës 10.04.2025, Akt Emërimet e anëtarëve të komisionit të pranimit, Aplikacionin me dokumentet e bashkëngjitura të kandidatit fitues, Njoftimin për kandidatin fitues të datës 25.04.2025, Lista përfundimtare e vlerësimit të kandidatëve e datës 25.04.2025, Formularët e vlerësimit individual të anëtarëve të komisionit për kandidatin fitues në intervistë të datës 25.04.2025.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkëngjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e parakohshme, sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me datë 25.02.2025 ka bërë shpalljen e konkursit me Nr.Reference RN00016856, Grupi i administrimit të përgjithshëm, pozita Zyrtar Administrativ, klasa e pozitës Profesional 3.

Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja, e cila me datë 10.04.2025 ka pranuar njoftimin se nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit, me arsyetimin se nuk ka paraqitur diplomën e shkollës së mesme apo ekuivalente me të, sipas kërkesave të përgjithshme formale të specifikuar në konkursin me nr. Reference RN00016856.

Ankuesja ka parashtuar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor, kundër procedurave të konkursit me nr.reference RN00016856 të datës 25.02.2025 Grupi i administrimit të përgjithshëm, pozita Zyrtar Administrativ, klasa e pozitës Profesional 3, të shpallur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, lidhur me konkursin për pranim me numër reference RN00016856 të datës 25.02.2025 për pozitën Zyrtar Administrativ, klasa e pozitës Profesional 3, me datë 10.04.2025 ka njoftuar, ankuesen se nuk i plotëson kriteret për përfshirje në listën e ngushtë, sepse aplikacionit të saj i mungon diploma e shkollës së mesme sipas kërkesave të përgjithshme formale.

Tutje nga administrimi i provave, Kolegji i Këshillit, konstanton se lista përfundimtare e vlerësimit të kandidatëve nga komisioni i pranimit është lëshuar me datën 25.04.2025 dhe njoftimi për kandidatin fitues është shpallur me të njëjtën datë 25.04.2025, moment nga i cili sipas dispozitave ligjore në fuqi të cekura më poshtë rrjedh afati i ankesës.

Lidhur me vendosjen në këtë çështje juridike administrative, Kolegji i Këshillit, ju referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik konkretisht nenit 39 paragrafi 12 i cili përcakton se: “12. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në

ligjin përkatës për procedurën administrative”, si dhe nenin 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, është përcaktuar se: “Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve”, dhe rrjedhimisht konstatoi se ankesa e ankueses e datës 15.04.2025, kundër konkursit për pozitën e lartcekur është e parakohshme, ngase me dispozitat përkatëse ligjore, kandidati për pranim në Shërbimin Civil ka të drejtë të parashtoj ankesë vetëm pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, ndërsa sipas shkresave të lëndës rezulton se në kohën e parashtrimit të ankesës së ankueses të datës 15.04.2025, nuk kishte përfunduar procedura e pranimit sipas konkursit me Nr.Reference RN00016856 për pozitën ‘Zyrtar Administrativ’ klasa e pozitës Profesional 3 në Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ngase sipas shkresave të lëndës, procedura e pranimit ka përfunduar sipas njoftimit për kandidatin fitues me datë 25.04.2025, për rrjedhojë Kolegji mbi bazë të konstatimeve si më sipër, vlerëson se ankesa e ankueses e datës 15.04.2025, pa u publikuar ende rezultatet përfundimtare është e parakohshme dhe si e tillë është e pa pranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.650/2025

Driton Jashari

Procesmbajtëse

Malsore Gashi - Bajraktari

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- I.R-Z;
- Udheheqësit të Burimeve Njerëzore, MFPT
- Arkivit të KPMSHCK-së.